

**E enjte, 18 korrik 2019 - Shenjtori i ditës:
Dëshmorët Emiliani, Pavli, Thea, Valentina,
Markeli. Oshënar Pamvoi. Oshënar Serafimi i
Sarovit.**



– Oshënar Pamvoi –

Oshënar Pamvoi ndriçoi në Nitri, në jug të Aleksandrisë. Të dhëna për të, në mënyrë më të zgjeruar, ekzistojnë në librin e Lavsaikut, Jerondikonit dhe Evergjetinosit. U luftua nga mendime blasfemie, por dëgjoi një zë, i cili e inkurajoi të mos dekurajohej, se ishte një kurth nga i ligu.

Për tre vjet lutej që të mos lavdërohej në tokë, por, sa më shumë lutej, aq më shumë Perëndia bënte që ai të lavdërohej. Oshënari ishte zbukurim i asketëve të malit të Nitrisë dhe gjithashtu bashkëkohës me shën Melaninë dhe shën Isidorin. Ishte i madh në gjithçka: në shpresëtarë, në ligjëratë, në heshtje, në këshillë, në butësi, në rreptësi, në përvojë, në njohuri, në urtësi, në thjeshtësi dhe, në përgjithësi, kudo. Nxori nxënës të admirueshëm, si episkop Dioskorin, Amonanë

dhe Joanin, nipin e Drakondit.

Njëherë, kur shën Melania (31 dhjetor) i dhuroi argjend të bollshëm atje në Nitri, ai e falënderoi, por ajo nuk arriti ta shihte, ndaj u mërzit e i tha: “Jeront, janë 150 kg!”. “E di Perëndia, bija ime...”, iu përgjigj ai, dhe urdhëroi ikonomin që ta ndante të gjithë argjendin në manastire të varfra, sepse vetë ai ushqehet me punëdoret që bënte.

Sa herë që i bënin pyetje në lidhje me Shkrimin e Shenjtë ose me tekste të tjera, përgjigjej pas shumë kohësh. Në meditim dhe saktësi ia kalonte edhe Andonit të Madh (17 janar), kështu që kurrë nuk pendohej për fjalët që kishte thënë. Këshillonte të ruhej e pastër dhe e pafajshme ndërgjegjja ndaj të afërmit. Theksonte bindjen dhe thjeshtësinë në veshje. I këshillonte laikët të puthnin duart e murgjve, sepse ato janë të shenjtëruara prej lutjeve dhe metanive.

Në Aleksandri, ku e ftoi Athanasi i Madh (18 janar), ai pa rastësisht një grua imorale, e cila ishte zbukuruar shumë nga pamja e jashtme, lotoi e tha: “Po unë a përpiqem t’i pëlqej Zotit kështu si kjo e gjora imoralëve?”.

Demonët, që t’i shkaktonin shpërqendrimin e mendjes, bënë dikur sikur po mundoheshin shumë të ngrinin një pupël. Oshënari qeshi kur i pa, ndërsa ata u gëzuan se menduan që e mundën. Por ai u sqaroi se qeshte me dobësinë e tyre.

Një ditë e vizitoi ava Piori (17 qershor), i cili, “që të mos i bëhej barrë”, kishte marrë ushqim me vete: pak bukë të tharë. Edhe oshënar Pamvoi, kur ia ktheu vizitën, mori me vete bukë të tharë, të cilën e kishte lagur. Edhe pse ishte gjithmonë i përmbajtur dhe ushtrohej ashpër, gëzonte shëndet të plotë dhe nuk u sëmur aspak në jetën e tij. Ishte kaq i përulur, saqë mendonte se nuk ishte as fillestar në virtyt.

Ndërroi jetë në moshën 70-vjeçare (më 417 siç mendohet). Vdekja e tij ishte jo vetëm e qetë dhe pa dhimbje, por edhe e pëlqyeshme prej Atit qiellor. Pak para fjetjes së tij, i dhuroi si kujtim Paladit, shkrimtarit të Lavsaikut, një shportë, të cilën sapo e kishte thurur. E varrosën fëmijët e tij shpirtërorë, duke lavdëruar Perëndinë që i bëri të denjë të mësoheshin prej këtij asketi të madh.

SHĒN
VALENTINA

SHĒN
PAMVOI

SHĒN
EMILIANI



Γ. Μ. Παναγράνου

- [Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)